

**STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Azur Agency"**

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1) Sot, më 15/05/2023, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **"Azur Agency"**.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:
  - a) **Paola Ribaj**, atësia Simo, shtetase shqiptare, identifikuar me anë të numërit personal të identifikimit J96002076W e datëlindjes 02/10/1999, lindur në GRC dhe banues në Vlorë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
  - b) **Deis Ribaj**, atësia Simo, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të numërit personal të identifikimit J61119078V, i datëlindjes 19.11.1996, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
  - c) **Simo Ribaj**, atësia Zeqir, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BD2268231, me numër personal identifikimi G702271350, i datëlindjes 27/02/1967, lindur dhe banues në Vranisht, Himarë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
  - d) **Anila Koçiu**, atësia Klement, shtetase shqiptare, identifikuar me anë të numërit personal të identifikimit H85713086I e datëlindjes 13/07/1978, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Vlorë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 2:**

**Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
  - a) Ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit të rezervimit dhe tregtimit të biletave të udhëtimit për klientët e tyre në mënyrë të lehtë dhe të përshtatshme.
  - b) Shërbime të tjera të ngjashme, që ofrohen si pjesë e shërbimit të udhëtimitve/pushimeve; ndërmjetësimin për shërbimin e akomodimit, ushqimit, transportit, guida turistike, vizita në qytete, muze, monumente të kulturës dhe të natyrës, shërbim i guidës dhe/ose përkthimit, importin dhe eksportin e materialeve të nevojshme për aktivitetin dhe shërbime e aktivitete të tjera të ngjashme, turizmin e natyrës dhe turizmin religjioz.
  - c) Ofrimin e shërbimeve shtesë si përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për udhëtim dhe informacione në lidhje me destinacionet e udhëtimit.
  - d) Ofrimi i shërbimit të dhënies me qera i makinave dhe mjeteve të tjera të transportit.
  - e) Ofrimi i shërbimeve të mjekësisë alternative dhe të ngjashme si këto.
  - f) Ndërmjetësim në sigurimin e lejeve të qëndrimit, punësim, viza turistike për shtetasit e huaj dhe shqiptare.
  - g) Ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit për dhënien me qera/shitjen e ambjenteve të banimit.
  - h) Shërbim exchange.
  - i) Shërbim pagese të faturave të ndryshme.
  - j) Transferim vlerash monetare
  - k) Agjent sigurimesh
  - l) Tregëtim produkte bio
  - m) Tregëti ambulante, pije freskuese
  - n) Ofrimi i transportit tokësore, detar dhe ajror.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Lagjia "10 Korriku, apartamenti 31, Vlorë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**KREU II  
KAPITALI**

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- a) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000 (një mijë) Lekë dhe është i ndarë në 4(katër) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - b) Ortaku themelues Paola Ribaj, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 510 (pesëqind e dhjetë) Lekë, që përben 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - c) Ortaku themelues Anila Koçiu, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 200 (dyqind) Lekë, që përben 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - d) Ortaku themelues Simo Ribaj, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 190 (njëqind e nëntëdhjetë) Lekë, që përben 19% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - e) Ortaku themelues Deis Ribaj, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) Lekë, që përben 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6:  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7  
Transferimi i kapitalit**

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes vetem brenda anetareve themelues;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit vetem brenda anetareve themelues;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku nuk mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

**Neni 9**  
**Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**Neni 10**  
**Kuorumi**

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave të aksioneve.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 11**  
**Marrja e vendimeve**

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve, për çështje të tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

#### **Neni 12**

##### **Përgjashtimi nga e drejta e votës**

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

#### **Neni 13**

##### **Administrimi**

- 1) Administratori i shoqërisë zgjidhet Paola Ribaj, atësia Simo, shtetase shqiptare, identifikuar me anë të numërit personal të identifikimit J96002076W e datëlindjes 02/10/1999, lindur në GRC dhe banues në Vlorë; me afat 5 vjet.
- 2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 3) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

#### **Neni 14**

##### **Kompetencat e Administratorëve**

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit**

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Padi tësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET**

##### **Neni 16 Viti Financiar**

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**  
**Shperndarja e fitimit**

Ne fund te vitit financiar fitimi i kompanise shperndahet midis ortakeve sipas aksioneve.

**Neni 18**  
**Invenstime**

Ne fund te vitit financiar bordi me shumice votash vendos qe nje pjese e fitimit apo i gjithe fitimi te investohet per zgjerimin e aktivitetit te kompanise.

**Neni 19**  
**Ekspertet**

- 1) Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 2) Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t’jua paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakeve për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

**KREU V**  
**PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 20**  
**Prishja dhe likuidimi**

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
  - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Ne këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “ Shoqëri ne likuidim e sipër “.
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 21**  
**Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni 22**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.


**Neni 23**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Azur Agency” shpk**

**Paola Ribaj**



**(Emër, Mbiemër,  
Nënshkrimi)**

**Anila Koçiu**




**(Emër, Mbiemër,  
Nënshkrimi)**

**Simo Ribaj**



**(Emër, Mbiemër,  
Nënshkrimi)**

**Deis Ribaj**



**(Emër, Mbiemër,  
Nënshkrimi)**